



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 166, datë 18.12.2020

P Ë R

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, TË DISA PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË DO TË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E DETYRAVE TË SAJ FUNKSIONALE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK SI DHE SHËRBIMEVE TË TJERA NË FUNKSION TË BASHKËSISË

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2, shkronja “a”, nenit 23, pikës 14, nenit 28, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; nenit 3, të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; vendimit nr. 500, datë 14.08.2001 të Këshillit të Ministrave “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; udhëzimit nr.15, datë 30.06.2003 të ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, si dhe në vijim të memos nr.prot. F-2756/6, datë 24.11.2020 të Drejtorisë së Pasurive të Paluajtshme, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të disa pronave të paluajtshme shtetërore që do të përdoren për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në fushën e planifikimit të territorit dhe zhvillimit ekonomik si dhe shërbimeve të tjera në funksion të bashkësisë, sipas formularëve bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO